

PARTIA DREJTESI INTEGRIM DHE UNITET - PDIU

TIRANE ALBANIA

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

DHE

**PASQYRA E FONDEVE TE PERFITUARA DHE TE
SHPENZUARA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE PER
ZGJEDHJET NE ORGANET E QEVERISJES VENDORE
08 MAJ 2011**

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

Lavdimir FUSHA

Lavdimir Fusha



PERMBLEDHJE

Raporti i audituesit te pavarur

PARTIA DREJTESI INTEGRIM DHE UNITET

Pasqyra e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara, gjate fushates zgjedhore per zgjedhjet ne organet e qeverisjes vendore me date 08 Maj 2011.

Shenime per pasqyrat financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe te shpenzuara, gjate fushates zgjedhore per zgjedhjet ne organet e qeverisjes vendore me date 08 Maj 2011.

I	Te pergjithshme	6
II	Politikat operuese	7
III	Rregullat e vleresimit	8
1	Fondet e perfituara gjate fushates zgjedhore , per zgjedhjet ne organet e qeverisjes vendore me date 08 Maj 2011.	8
1.1	Fondet publike	8
1.2	Fondet jo publike	8
1.2.a	Burimet e veta	8
1.2.b	Sponsorizimet	8
1.2.ba	Sponsorizime te perfituara mbi 100 mije leke	8
1.2.bb	Sponsorizime te perfituara nen 100 mije leke	8
1.2.bc	Sponsorizime te perfituara ne materiale e sherbime	8
2	Fondet e shpenzuara gjate fushates zgjedhore , per zgjedhjet ne organet e qeverisjes vendore me date 08 Maj 2011.	9
3	Likuiditetet	10
4	Kreditore te palikujduar	11
5	Dokumentacioni dhe rregjistrimi i fondeve jopublike	12
6	Ngjarje te me vonshme	13

Jonh



RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVAU

Drejtuar :
Komisionit Qendror te Zgjedhjeve:
Pallati i Kongreseve ,
Tirane Albania

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkelidhur te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per zgjedhjet ne organet e qeverisjes vendore date 08 Maj 2011 , nga Partia Drejtesi Integrim dhe Unitet e Shqiperise” - PDIU (e quajtur me tej ”Organizate Politike”), per periudhen 08 Prill 2011 deri me 08 Maj 2011.

Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi mban pergjegjesi per perгатitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave ne perputhje me Ligjin Nr. 10019, date 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise” dhe Ligjin Nr. 9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” date 29.04.2004. Kjo pergjegjesi perfshin: dokumentacionin mbartes te fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera, politiken kontabel te ndjekur per hartimin e pasqyrave financiare per fondet e perfituara dhe shpenzimeve te realizuara per fushaten zgjedhore per zgjedhjet ne organet e qeverisjes vendore, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per perгатitjen e pasqyrave financiare qe mos permbajne anomali dhe gabime materiale. Mbi kete baze, fondet e perfituara njihen kur fitohen ne leke ose ne materiale dhe shërbime te konvertuara ne leke dhe shpenzimet njihen si te tilla ne momentin qe ato jane kryer dhe jo kur ato paguhen.

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia e jone eshte qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare , per fondet e perfituara dhe te shpenzuara gjate fushates zgjedhore per zgjedhjet ne organet e qeverisjes vendore me date 08 Maj 2011. Auditimin e kemi kryer ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat e etikes dhe qe te planifikohet dhe te kryhet auditimi per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali dhe gabime materiale.

Nje auditim perfshin kryerjen e procedurave, mbi bazen e testeve, te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare. Keto procedura te cilat zgjidhen ne varesi te gjykimit te audituesit, perfshijne vleresimin e rrezikut te gabimeve materiale te pasqyrave fianciare, qe mund te kene ndodhur per shkak te mashtrimit ose te gabimeve.



Per realizimin e vleresimit te ketyre rreziqeve, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare me qellimin qe te hartoje procedura te auditimit te pershtatshme sipas situates, por jo me qellimin e shprehjes se nje opiniononi ne lidhje me efektivitetin e kontrollit te brendshem te subjektit. Nje auditim perfshin vleresimin e pershtatshmerise te politikave kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e vleresimeve kontabel te bera nga drejtimi si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme qe evidenca e auditimit qe kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per tu perdorur si baze ne dhenien e opinionit tone te audituesit.

Opinion

Sipas opinionit tone, pasqyrat bashkalidhur , te marra ne teresi dhe ne te gjithe aspektet materiale, japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga Partia Drejtesi Integrim dhe Unitet – PDIU, gjate fushates zgjedhore per zgjedhjet ne organet e qeverisjes vendore 08 Maj 2011, ne perputhje me te drejten e perfitimit te fondit dhe kryerjes se shpenzimit, ne pajtim me ligjin 10019, date 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise dhe ligjin Nr.9228, date 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Firma : ALB BB AUDITING SHPK
TIRANE

Titullari : Lavdimir Fusha
Eksperti Kontabël i Rregjistruar

Lavdimir Fusha
Fusha



Datë : Janar / 2012

Adresa: Rr. Bulv "Gjergj Fishta", Nd. 16, H.9, Ap. 20,
Njesia Bashkiake Nr. 10, Kodi Postar 1001 ,
Tiranë -Albania

Tel: + 2 427 019
Mob. 0692067870

**PASQYRA E FONDEVE TE PERFITUARA DHE TE SHPENZUARA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE
PER ZGJEDHJET NE ORGANET E QEVERISJES VENDORE 08 MAJ 2011**

Nota	Pershkrimi	Fonde te perfituara e shpenzuara me levizjet e brendshme	Fonde te perfituara e shpenzuara pa levizjet e brendshme	Vlera e perfituar dhe shpenzua Ne Leke	Ne %
a	b	1	2	3	4
1	Fondet e perfituara (1.1 + 1.2)	15,318,100	13,491,652	13,491,652	
1.1	Nga fondet publike	7,911,752	7,911,752	7,911,752	58.64
1.1.a	Ministria e Financave shkresa nr. 6960/1, date 25.03.2011	7,679,609	7,679,609		
1.1.b	Ministria e Financave shkresa nr. 8444/1, date 02.04.2011	232,143	232,143		
1.2	Nga fondet jopublike		5,579,900	5,579,900	41.36
1.2.a	Nga burimet e veta (Te rikthyera)	1,826,448			
1.2.b	Nga sponsorizimet	5,579,900	5,579,900		
1.2.b1	Spons. te perfituara mbi 100 mije leke	5,492,600	5,492,600		
1.2.b2	Spons. te perfituara nen 100 mije leke	87,300	87,300		
1.2.b3	Donacionet e perfituara ne natyre	0	0		
	Total fonde te perfituara (bruto)	15,318,100			
	Te arketuara nga llogarite bankare	13,491,652			
	Te arketuara nga llogarite e Arkes	1,826,448			
2	Fonde te shpenzuara		12,972,915	12,972,915	100.00
a	Qera zyre	704,500	704,500		
b	Qera salle	450,000	450,000		
c	Publicitet	1,533,600	1,533,600		
d	Reklama	40,000	40,000		
e	Trasmetim spotesh	8,843,157	8,843,157		
f	Flamuj te partise	410,965	410,965		
g	Promocione- ora me logun e partise	965,483	965,483		
h	Te tjera	24,377	24,377		
i	Komisione bankare	333	333		
j	Rikthim te burimeve te veta	1,826,448			
	Total fonde te shpenzuara (bruto)	14,799,363			
	Pagesa te kryera nga llogaria Bankare	11,146,467	11,146,467		
	Pagesa te kryera nga Arka	1,826,448	1,826,448		
	Levizja e brendshme	1,826,448	0		
	Balance – Fonde te pa perdorura	518,737	518,737	518,737	3.84

Justina



PARTIA DREJTESI INTEGRIM DHE UNITET - PDIU

Shenime per pasqyrat financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe te shpenzuara gjate fushates zgjedhore, per zgjedhjet ne organet e qeverisjes vendore me 08 Maj 2011

I. Te pergjithshme

Ne dokumentacionin ne Zyren e Regjistrimit te Partive Politike, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, rezulton te jete e miratuar krijimi i forces politike "Partia Drejtasi Integrim dhe Unitet", me iniciale "PDIU". Qellimi dhe objektivat e kesaj partie jane te percaktuara ne program dhe statut. Partia Drejtasi Integrim dhe Unitet, ka per qellim te siguroje dinjitetin shpirtoror dhe aspiratat ekonomike si dhe shoqerore te popullit shqiptar, ne respektin per traditat dhe unitetin kombetar, ne perputhje me vlerat e lirise personale dhe solidaritetit ne pergjithesi, ne perputhje te vazhdueshme me parimet demokratike dhe rregullat e institucioneve perfaqesuese. Partia Drejtasi Integrim dhe Unitet, njesohet me kulturen perndimore dhe europiane dhe zhvillon angazhimin e saj politik per te nxitur bashkejetesen paqesore te popujve, shteteve, etnive, racave dhe feve. Partia Drejtasi Integrim dhe Unitet beson ne pjesemarrjen popullore si nje kusht paresor per takimin e frytshem mes aftesive, kultures dhe profesionalizmit.

Organizimi dhe drejtimi

PDIU eshte nje parti politike qe vepron ne territorin e Republikes se Shqiperise. Ajo organizohet sipas parimit territorial ne nivel lokal dhe qendror. PDIU eshte nje parti elektorale qe vepron sipas parimeve te njohura demokratike dhe eshte e organizuar vertikalisht dhe koordinuar nga qendra.

Instancat dhe organet qendrore te PDIU jane:

Kuvendi i Partise;

Keshilli Kombetar;

Kryetari dhe zevendesit e tij;

Kryesia e PDIU;

Sekretari i pergjithshem;

Burimet e financimit te Partise jane:

Te ardhurat nga kuotizacionet;

Te ardhurat nga buxheti i shtetit ne perputhje me ligjislacionin per financimin e partive politike;

Ndihmat dhe dhuratat e antaresise dhe te perkrahesve te PDIUSH;



Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me ligjislacionin për financimin e partive politike.

Selia, simbolet dhe vula

Selia qendrore e Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet, është në Tiranë, Rruga e Elbasanit, Pallati përballë Postes, Kati i tretë.

Inicialet e partisë :

Inicialet e Partisë “Drejtesia Integrim dhe Unitet”, do të jenë tre shkronjat e para të secili emër : PDIU.

Flmuri i partisë :

Flamuri i partisë do të ketë sfond blu , dhe një dege ulliri jeshile, si dhe inicialet “PDIU”.

Logoja e partisë :

Logoja e partisë do të ketë të njëjten grafikë me flamurin.

Vula e partisë :

Vula e Partisë “Drejtesia Integrim dhe Unitet” do të jetë e rrumbullakët, për qark rrethit të vules duhet të jetë i shkruar i plotë emri i partisë: Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet ; kurse në qendër të rrethit duhet të jenë të vendosur inicialet PDIU dhe logoja.

II. Politikat operuese

Drejtimi i Partisë, ka operuar për këtë periudhë që auditohet në pajtim me ligjin 10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë dhe ligjin Nr.9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare i datës 29.04.2004, dhe në konformitet me objektin e veprimtarisë për të cilin është krijuar dhe programi të caktuar nga organet qendrore.

III. Rregullat e vleresimit

Menyra e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Gjendja u përgatit me qëllimin për të raportuar tek Komisioni Qendror Zgjedhor , për fondet e përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore , për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore me datë 08 Maj 2011.

Kontabiliteti është ndërtuar mbi bazën e parimeve të konstatimit. Sipas kësaj mënyre fondet e përfituara në të holla janë rregjistruar në momentin e arketimit të tyre dhe fondet e përfituara në natyrë dhe shërbimet në momentin e kryerjes duke i konvertuar në leke me cmimin e tregut dhe shpenzimet janë pasqyruar në momentin e konstatimit të tyre kur janë kryer.

Administrimi i fondeve të përfituara dhe të shpenzuara është bërë nga Selia Qendrore, duke respektuar rregullat për mënyrën e organizimit e mbajtjes së dokumentacionit, si dhe ato për hartimin e Pasqyrave Financiare për fondet e përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore të datës 08 Maj 2011, për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore.



Monedha e raportuar

Drejtimi financiar i Partise ka perdorur si monedhe baze raportimi monedhen kombetare Leke. Fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera jane mbartur ne dokumentacionin fillestar ne monedhat All, Usd dhe Euro ose ne kontribute ne natyre. Gjendjet jane pergatitur ne Leke. Fondet dhe shpenzimet e emetuara ne monedha te huaja jane konvertuar ne Leke, bazuar ne kursin e kembimit te dates qe eshte kryer transaksioni, dhe donacionet ne natyre jane vleresuar ne Leke me cmimin e tregut ne momentin e perfitimit.

Taksat dhe Kontributet

Partia eshte e perjashtuar nga taksat mbi fitimin. Partia i ka shlyer detyrimet qe lindin per Sigurimet Shoqerore dhe Shendetesore te punonjesve dhe per Tatimin mbi te ardhurat personale.

1. FONDET E PERFITUARA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE PER ZGJEDHJET NE ORGANET E QEVERISJES VENDORE DATE 08 MAJ 2011

Nota	Pershkrimi	Fonde te perfituara me levizjet e brendshme	Fonde te perfituara pa levizjet e brendshme	Vlera e perfituar Ne Leke	Ne %
a	b	1	2	3	4
1	Fondet e perfituara (1.1 + 1.2)	15,318,100	13,491,652	13,491,652	
1.1	Nga fondet publike	7,911,752	7,911,752	7,911,752	58.64
1.1.a	Ministria e Financave shkresa nr. 6960/1, date 25.03.2011	7,679,609	7,679,609		
1.1.b	Ministria e Financave shkresa nr. 8444/1, date 02.04.2011	232,143	232,143		
1.2	Nga fondet jopublike		5,579,900	5,579,900	41.36
1.2.a	Nga burimet e veta (Te rikthyer)	1,826,448			
1.2.b	Nga sponsorizimet	5,579,900	5,579,900		
1.2.b1	Spons. te perfituara mbi 100 mije leke	5,492,600	5,492,600		
1.2.b2	Spons. te perfituara nen 100 mije leke	87,300	87,300		
1.2.b3	Donacionet e perfituara ne natyre	0	0		
	Total fonde te perfituara (bruto)	15,318,100			
	Te arketuara nga llogarite bankare	13,491,652			
	Te arketuara nga llogarite e Arkes	1,826,448			

1.1.Fondet Publike



Ne datën 18 Prill 2011 janë kaluar në llogarinë Nr. 411445169 dhe IBAN : AL39 2051 1117 4451 69CL TJCL ALLG të BANKES KOMBETARE TREGTARE – Dega Laprak Tiranë, celur nga Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet sipas kërkesave të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Per kodin zgjedhor në Republikën e Shqipërisë”, nga Ministria e Financave shuma 7,679,609 leke, transferim fondi buxhetor sipas shkresës Nr. 6960/1, datë 25.03.2011 për fushatën zgjedhore 08 Maj 2011.

Gjithashtu po nepërmjet kësaj llogarie bankare, me datë 19 Maj 2011 janë kaluar nga Ministria e Financave shuma 232,143 leke, transferim fondi buxhetor sipas shkresës Nr. 8444/1, datë 02.04.2011.

Gjithesëj sipas nenit 87 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Per kodin zgjedhor në Republikën e Shqipërisë”, për fushatën zgjedhore për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore me datë 08 Maj 2011, **Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet ka përfituar fonde publike 7,911,752 leke.**

1.2 Fonde jopublike.

Në zbatim të nenit 89 Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Per kodin zgjedhor në Republikën e Shqipërisë”, **Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet ka përfituar fonde jopublike 5,579,900 leke,** të cilat sipas burimeve klasifikohen.

1.2.a. Burime të Veta

Aktualisht drejtimi i selisë së Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet, nuk ka shpenzuar fonde nga burimet e veta për fushatën zgjedhore të datës 08 Maj 2011, për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore. Por, me qëllimin për të paraprirë në kohë fushatën dhe në kushtet që nuk i ishin bërë të disponueshme si fondet publike dhe ato jopublike, ajo ka vënë në dispozicion të perkoshem mjete monetare të vetat për blerjen dhe pagesën e disa shërbimeve në shumën **1,826,448 leke** si: pagesa e kryer për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare në vlerën 450,000 leke për marrje salle me qera, blerje flamur me logon e partisë në vlerën 410,965 leke, blerje materiale promovionale si ora e të tjera me logon e partisë në vlerën 965,483 leke.

Ky fond i është rikthyer në perfundim të fushatës dhe është gjendja e mbetur në llogarinë bankare me Nr. 411445169 dhe IBAN : AL39 2051 1117 4451 69CL TJCL ALLG të BANKES KOMBETARE TREGTARE – Dega Laprak Tiranë, të celur nga Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, në shumën 2,345,185 leke që përfaqëson shumën e burimeve të veta të vena në dispozicion të perkoshem në fillim të fushatës në vlerën 1,826,448 leke plus vlerën 518,737 leke (Diferenca midis fondeve të përfituara 13,491,652 leke dhe fondeve të shpenzuara 12,972,915 leke).

1.2.b. Sponsorizimet

Për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore me datë 08 Maj 2011, **Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet**, ka përfituar në formën e dhurimit nga persona fizikë e persona juridikë vendas shumën prej **5,579,900 leke**, nga e cila nën 100 mijë leke në shumën 87,300 leke, dhe mbi 100 mijë deri me 1 milion leke në shumën 5,492,600 leke, sipas listës si më poshtë vijon :

[Signature]



